

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"Toscana AgroVital" SHPK

Me date 10.11.2021, themeluesi i meposhtem:

Shoqeria "ZITA" SHPK, me seli ne Tirane, Njesia Administrative nr.5, Rruga Janos Hunyadi, Ndertesa nr.34, kati perdhe, Kodi Postar 1019, nje shoqeri e krijuar qe vepron si person juridik ne baze te ligjeve shqiptare, regjistruar ne Qendren Kombetare te Biznesit me date 18/06/2021, me NIPT M11818017I, me status aktiv, qe ligjerisht perfaqesohet nga Administratori Znj. Brunilda Hasanllari, madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar, ka vendosur krijimin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe nenshkruan Aktin e Themelimit te meposhtem te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar, aktiviteti i se ciles rregullohet nga legjislacioni shqiptar, nga percaktimet ne kete Akt Themelimi dhe nga Statuti i saj, i cili eshte pjese perberese e ketij akti.

KREUI I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria "Toscana AgroVital" SHPK, eshte person juridik i se drejtes shqiptare. Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, me poshte e quajtur "Shoqeria".

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi te jete regjistruar ne QKR, ne perputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj. Shoqeria, pasi te kete fituar personalitetin juridik, eshte pergjegjese ndaj te treteve per detyrimet dhe demet e shkaktuara gjate veprimtarise se saj.

Neni 3
Selia

Tirane, Ndroq, Vila Toscana, Objekt i ndodhur ne Zonen kadastrale Nr. 2776, Nr. pasurie 528/26, Volumi 9, Faqe 208.

Neni 4
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te papercaktuar duke filluar nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.

Neni 5
Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kete si objekt te veprimtarise:

Aktivitete ne fushen e organizimit dhe drejtimi i struktures akomoduese, hotel, organizim evetensh dhe festash te ndryshme, sherbim restoranti, bari, i pozicionuar ne zone rurale, aktivitet si operator turistik qe ofron/mundeson per vizoret e turistet veprimtari argetuese/shplodhese, qe lidhen me

fermen (si, p.sh., por pa u kufizuar ne mbjellje/vjelje te produkteve bujqesore, aktivite te lidhura me kafshet, degustim te produkteve etj.) ose jashte fermes (si, p.sh., por pa u kufizuar ne hipizem, ecje ne natyre etj.) Shoqeria mund te kryeje cdo aktivitet tjeter biznesi i cili nuk eshte i ndaluar nga ligji i zbatueshem ne Republiken e Shqiperise.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte **100.000 (njqind mije) leke**, i perbere nga nje kuote e vetme me vlere te pergjithshme **100.000 (njqind mije) leke**, e cila perben **100%** te kapitalit themeltar te shoqerise.

Ortaku themelues i Shoqerise "Toscana AgroVital" SHPK, "ZITA" SHPK eshte zoteruese e 1 (nje) kuote me vlere 100.000 (njqind mije) leke, e cila perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Pjeset e kapitalit themeltar mund t'u transferohen personave te trete qe nuk bejne pjese ne shoqeri, vetem me miratimin e Ortakut te vetem.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie. Ato jane te transferueshme edhe ne rast ndarjeje pasurore mes bashkeshorteve. Gjithashtu jane te transferueshme ndermjet bashkeshorteve si dhe ndermjet paraardhesve dhe pasardhesve. nepermjet akteve ligjore.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarres

1. Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e meposhtme:
 - a. Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b. Ndryshimet e statutit;
 - c. Emerimin e shkarkimin e administratorit/ve;
 - ç. Emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
 - d. Percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike;
 - dh. Mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - e. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - ë. Zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit;
 - f. Pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;



- g. Perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
 - gj. Riorganizimin dhe prishjen e shoqerise;
 - h. Miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
 - i. Ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.
2. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e percaktuara ne shkronjat "e" dhe "ë" te pikes 1 te ketij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates.
 3. Te drejtat dhe detyrimet e asamblese se pergjithshme ushtrohen nga Ortaku i vetem. Te gjitha vendimet e marra nga Ortaku i vetem regjistrohen ne nje regjister te vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen. Duhet regjistruar ne veçanti, por pa u kufizuar ne to, vendimet per:
 - a. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
 - b. Shperndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c. Investime;
 - ç. Vendimet per riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- Vendimet e paregjistruara ne regjistrin e vendimeve jane absolutisht te pavlefshme. Shoqeria nuk mund t'i kundrejtoje pavlefshmerine te tretit qe ka fituar te drejta ne mirebesim, pervec rastit kur shoqeria provon se i treti ka pasur dijeni per pavlefshmerine, apo ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishte pasur dijeni per te.
4. Ortaku i vetem mund te perfaqesohet edhe nga nje tjetër person, nepermjet prokures.
 5. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjithshme thirret te pakten nje here ne vit.

Neni 9 **Ndryshimet e Statutit**

Ndryshimet e statutit vendosen nga Ortaku i vetem.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane Qendres Kombetare te Regjistrimit per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 10 **Administrimi**

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te vetem te shoqerise.

Ortaku i vetem vendos per sistemin e administrimit, dhe ne rastin e nje organi administrativ me shume administratore, percakton numrin e tyre dhe kompetencat.

Administratori/ret, mund te jene ose jo ortake te shoqerise.

Administratori mund te shkarkohet ne çdo kohe.

Administrator i shoqerise eshte Znj. Arjola Naçi, e datelindjes 24.11.1992, identifikuar me leternjoftimin me Nr.Personal J26124038B.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e tij ne kete detyre per nje periudhe **pese vjeçare**, sipas ligjit.

Neni 11 **Kompetencat e Administratorit**

Shoqeria administrohet nga nje Administrator i vetem.

Administratori ka te drejte e detyrohet te:

- a. Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e pergjithshme;
- b. Kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te

- shoqerise;
- c. Pergatit dhe nenshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, i paraqet keto dokumente perpara asamblese se pergjithshme per miratim;
 - ç. Krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rrethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
 - d. Kryen regjistrimet dhe dergon te dhenat e detyrueshme te shoqerise, siç parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Regjistrimit;
 - dh. Raportoje perpara asamblese se pergjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posaçme me rendesi te veçante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
 - e. Administratori ka te drejte te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te zakonshem e te Jashtezakonshem;
 - ë. Administratori perfaqeson shoqerine perpara te gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo te huaj, autoriteteve shtetere Shqiptare apo te huaja, perfshi ketu autoritetet gjyqesore te te gjitha shkalleve;
 - f. Administratori ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne marredhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat me perjashtim te kompetencave qe ligji ia jep shprehimisht ortakeve te shoqerise;
 - g. Administratori angazhon shoqerine ne marredheniet me te tretet nepermjet akteve qe jane ne perputhje me objektin e saj;
 - gj. Administratori ka gjithashtu te drejte te nenshkruaje kontrata te ndryshme ne emer e per llogari te Shoqerise, perfshire ketu kontratat e qirase, shitjes, blerjes, kredive a hipotekimit te pasurive te paluajtshme, te nenshkruaje aktet e themelimit te shoqerive te tjera ku Shoqeria eshte ortak;
 - h. te nenshkruaje e hartoje çdo dokument e te kryeje ne emer te Shoqerise çdo veprim perballe te gjitha Bankave shqiptare apo te huaja ne lidhje me çeljen apo mbylljen e llogarive rrjedhese te Shoqerise, nenshkrimi i kontratave te ndryshme bankare per financimin e Shoqerise si dhe te kryeje veprime terheqje e derdhje shumash nga keto llogari pa limit;
 - i. Shoqeria nuk merr persiper pasojat ndaj te treteve kur ajo provon se te tretet e dinin qe akti i administratorit e kalonte objektin e shoqerise ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt ne rrethanat e dhena, duke pasur parasysh faktin se vetem shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme;
 - j. Klauzolat e ketij statuti qe kufizojne kompetencat e administratorit, te cilat rrjedhin nga ky nen, duhet te respektohen nga te tretet;
 - k. Administratorit ose ortakut qe nuk eshte person juridik, nuk u lejohet te kontraktojne ne çfaredolloj forme qofte, te marrin hua te shoqeria, te japin pelqimin ne emer te saj, per paradhenie si dhe te behen dorezenes apo te garantojne ne emer te saj angazhimet ndaj te treteve. Ne rast te kundert kontrata eshte e pavlefshme;

Neni 12 **Viti Financiar**

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor.
Perjashtimisht viti i pare - financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise prane Qendres Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.



Neni 13
Shperndarja ose prishja e shoqerise

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe dhe per çfaredo shkak, edhe para plotesimit te afatit per te cilin eshte krijuar siç mund te jene:

- a) Humbja e kapitalit ose pamundesia e vazhimit te metejshem te veprimtarise se saj;
- b) Ne nje nga menytrat e parashikuara nga ligji "Per Falimentimin e Shoqerive Tregtare"
- c) Kur plotesohet afati i caktuar per ushtrimin e veprimtarise tregtare.

Ne kete rast Ortaku i vetem merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Neni 14
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete Akt Themelimi dhe legjislacionit shqiptar.


Per sa nuk parashikohet ne kete Akt Themelimi, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë që ka lidhje me objektin e veprimtarise se shoqerise.

Neni 15
Dispozita Perfundimtare

Ky akt themelimi u hartua ne 3 ekzemplare me permbajtje dhe vlera te njejta juridike, dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaku themelues i shoqerise tregtare "**Toscana AgroVital**" SHPK,

ORTAKU THEMELUES
"ZITA" SHPK

Banilda Hoxha



ATIS ©
INDONESIA